



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Syllabusi i lëndës: Menaxhmenti Financiar i Avancuar

Të dhëna bazike të lëndës

Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Menaxhmenti Financiar i Avancuar
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I (sems. I)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detaje kontaktuese:	

Përshkrimi i lëndës

Lënda **Menaxhmenti Financiar i Avancuar** ofron një qasje të thelluar dhe gjithëpërfshirëse mbi konceptet kyçe të menaxhimit financiar në ndërmarrje, duke u përqendruar në vendimet strategjike që ndikojnë në performancën afatgjatë dhe qëndrueshmërinë financiare të organizatave.

Studentët do të eksplorojnë temat që lidhen me vendimet mbi strukturën e kapitalit dhe burimet e financimit, analizën dhe menaxhimin e rrezikut financiar, vlerësimin e investimeve dhe kthimet, si dhe politikat e dividendëve. Gjithashtu, lënda trajton teknika të avancuara për vlerësimin e kompanive dhe pasqyrimin e ndikimit të vendimeve financiare mbi vlerën e aksionarëve.

Qëllimet e lëndës:

Kursi synon të ofrojë njohuri të avancuara dhe t'i pajisë studentët me aftësitë e nevojshme për të aplikuar në mënyrë efektive konceptet, teoritë dhe metodat e menaxhimit financiar të biznesit. Qëllimi është që studentët të zhvillojnë aftësinë për të analizuar dhe interpretuar problematika komplekse financiare, duke bërë ndërlidhjen e tyre me fushat e tjera ekonomike. Përmes këtij programi, ata do të jenë të aftë të zhvillojnë opinione të mirëinformuara dhe të bazuara në analiza të qëndrueshme, të cilat kontribuojnë në marrjen e vendimeve strategjike dhe të qëndrueshme në menaxhimin financiar.

Rezultatet e pritura të nxënies:	Njohuri (NJ): *NJ1: Zotëron njohuri të avancuara për objektivat financiare dhe mjedisin ekonomik të biznesit, duke përfshirë ndikimin e tregjeve dhe institucioneve financiare në vendimmarrjen strategjike të ndërmarrjeve. *NJ2: Zotëron njohuri mbi burimet e financimit dhe politikat e dividendëve, duke qenë në gjendje të shpjegojë ndikimin e levës financiare në strukturën e kapitalit të ndërmarrjes. *NJ3: Zotëron njohuri të thelluara mbi politikat e dividendit dhe leverazhin financiar, duke qenë në gjendje të shpjegojë efektet e tyre mbi koston e kapitalit dhe strukturën e kapitalit. Aplikim-Kompetenca (A-K): **A-K1: Aplikon metoda të avancuara për menaxhimin dhe financimin e kapitalit qarkullues, duke zhvilluar strategji efektive për optimizimin e likuiditetit dhe burimeve të financimit afatshkurtra. **A-K2: Përdor teknika të rrjedhave të skontuara të arkës për të vlerësuar investimet dhe për të llogaritur ndikimin e inflacionit dhe tatimeve në kthimet e investimeve. **A-K3: Kryen analizën e koston së kapitalit dhe përdor njohuritë për të zhvilluar strategji të strukturuar të kapitalit, me qëllim optimizimin e performancës financiare të ndërmarrjes. **A-K4: Aplikon teknika të menaxhimit të riskut financiar, duke përdorur strategji për të minimizuar ndikimin e pasigurisë dhe variablave të jashtëm në vendimmarrjen financiare të ndërmarrjes. Aftësi (A): ***A1: Zhvillon aftësi të komunikimit dhe bashkëpunimit gjatë prezantimit të punimeve shkencore dhe diskutimeve mbi vendimet financiare në grup. ***A2: Përdor aftësitë analitike për të kryer teste vlerësuese dhe për të formuluar opinione të bazuara në analizë të thellë mbi ndikimin e politikave financiare në vlerën e ndërmarrjes. <i>Sqarim:</i> Rezultatet e pritura të syllabusit janë të përpiluara konform rezultateve të pritura të programit, në përputhje me standardet e AKA-së. *Njohuri (Nj) **Aplikim-Kompetenca (A-K) **Aftësi (A)
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të)	

studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Teste, detyra të shtëpisë	2	5	10
Seminare, projekte kërkimore, prezentimet,etj.	10	1	10
Koha e studimit vetanak të studentit	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	10	1	10
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Totali			150
Sqarim: 1 orë = 25 ECTS kredi.			
Përshtatja e ECTS me orët totale: 150 orë ÷ 25 = 6 ECTS kredi.			
Metodologjia e mësimdhënies:	• Prezantimi i temës mësimore në Power Point • Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime • Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjruar		
Metodat e vlerësimit:	• Testi i parë vlerësues: 0 - 40% • Testi i dytë vlerësues: 0 - 40% • Punimi hulumtues: 0 - 20% ose • Provimi përfundimtar: 0 - 80%		
Literatura			
Literatura bazë:	▪ SHKÇAK – Menaxhmenti Financiar (P7), Tekst studimi, Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës, [BPP Learning Media Ltd ; Prishtinë: Twins, 2015 – Edicioni i shtatë.		
Literatura shtesë:	▪ Michael Ehrhardt & Eugene Brigham – Drejtimi financiar – teori dhe praktikë, Mediaprint 2013. ▪ Halit Xhafa, Beshir Ciceri – Drejtimi financiar, Tiranë 2014.		

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje (Prezantimi i lëndës, metodat e punës dhe vlerësimit)
Java e dytë:	Menaxhimi financiar dhe objektivat financiare
Java e tretë:	Mjedisi ekonomik i biznesit Tregjet dhe institucionet financiare
Java e katërt:	Kapitali qarkullues
Java e pestë:	Menaxhimi i kapitalit qarkullues
Java e gjashtë:	Financimi i kapitalit qarkullues
Java e shtatë:	Vendimet për investimet
Java e tetë:	Testi i parë vlerësues
Java e nëntë:	Vlerësimi i investimeve me anë të metodave për rrjedhat e skontuara të arkës
Java e dhjetë	Llogaritjet për inflacionin dhe tatimet
Java e njëmbëdhjetë:	Burimet e financimit
Java e dymbëdhjetë :	Politikat për dividendë dhe leva financiare
Java e trembëdhjetë:	Kostoja e kapitalit
Java e katërmbëdhjetë:	Struktura e kapitalit
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i dytë vlerësues Prezentimi i punimeve shkencore

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së. • Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore; • Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore; • Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim; • Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit; • Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale. • Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.

